

REZILIENCA DHE STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TEK PRINDËRIT E  
FËMIJËVE ME AUTIZËM: STUDIM I KOMBINUAR

TEMA PËR TITULLIN MASTER  
I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

SABINA KRASNIQI - JAHA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM  
PRISHTINË

QERSHOR, 2023

EKSPOZE E TEMËS  
REZILIENCA DHE STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TEK PRINDËRIT E  
FËMIJËVE ME AUTIZËM: STUDIM I KOMBINUAR

**Mentori:**

**Kandidatja:**

Prof. Ass. Dr. Liridona JEMINI-GASHI

Sabina KRASNIQI - JAHA

Qëllimi i përgjithësuar i këtij studimi ishte përdorimi i kombinuar i metodave kuantitative dhe kualitative për të siguruar një të kuptuar më të thellë të ndërlidhjes mes strategjive të përballimit dhe reziliencës tek prindërit e fëmijëve të diagnostifikuar me autizëm. Punimi është ndarë në pesë kapituj, duke filluar nga pjesa hyrëse që është shqyrtimi i literaturës, duke vazhduar me kornizën konceptuale teorike, metodologjinë e hulumtimit, rezultatet dhe diskutimi.

KAPITULLI 1: HYRJA/SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në kapitullin e parë tregohet qëllimi i këtij hulumtimi duke u prezantuar kështu definimi i variablave kyçe të studimit, ndërlidhja mes tyre dhe rezultatet e hulumtimeve të tjera të bëra në këtë drejtim. Prindërimi i fëmijëve me një paaftësi mund të prodhojë stres të madh dhe një ndjenjë jobalanci në sistemin familjar (Burrell, Thompson, & Sexton, 1994). Tre prej faktorëve më stresues sa i përket prindërimit të një fëmije me autizëm janë përhershmeria e gjendjes, mungesa e pranimit të sjelljeve autistike nga shoqëria dhe shpeshherë nga pjestarët e tjerë të familjes, dhe niveli shumë i ulët i mbështetjes sociale (Gray & Holdem, 1992).

Andaj bazuar në variablat e studimit dhe në shqyrtimin e literaturës janë parashtruar pyetjet e mëposhtme kërkimore:

PK1.A ekziston një ndërlidhje mes reziliencës dhe strategjive të përballimit tek prindërit e fëmijëve me ASD?

PK2: Cilat janë përvojat e prindërve gjatë rritjes së një fëmije me ASD?

PK3: Cila janë strategjitë që përdorin prindërit për të përballuar rritjen e një fëmije me ASD?

## KAPITULLI II: KORNIZA KONCEPTUALE TEORIKE

Në këtë studim, Korniza e Reziliencës Familjare dhe Modeli Transaksional i Lazarusit janë përdorur si korniza teorike për të përshkruar se si prindërit zhvillojnë mekanizmat e përballimit për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë dhe të ruajnë reziliencën. Pavarësisht sfidave të shumta gjatë rritjes së fëmijëve me ASD, familjet mbijetojnë përmes një numri të strategjive të përballimit dhe në këtë hulumtim janë zbuluar dy forma të cilat janë: burimet e ndryshme të trajtimit dhe mbështetja familjare.

## KAPITULLI III: METODOLOGJIA

Sa i përket metodës, gjatë këtij studimi është përdorur metoda kuantitative dhe kualitative apo thënë ndryshme metoda e përzier/mix method, pasi që synim kyç ka qenë mbledhja e të dhëna të detajuara për variablat studiuese. Pjesëmarrës të këtij studimi ishin 45 prindër të fëmijëve të diagnostifikuar me autizëm, të cilët kanë plotësuar pyetësorët: inventarin COPE (Carver, Scheier, & Weintraub, 1989) dhe Family Resilience Scale; FRAS (Sixbey, 2005). Tutje, janë realizuar tre intervista gjysmë të strukturuar me tre nëna që kishin fëmijët të diagnostifikuar me çrregullimin e spektrit të autizmit. Në këtë kapitull po ashtu është paraqitur procedura që është ndjekur gjatë tërë hulumtimit si dhe konsiderata etike.

## KAPITULLI IV: REZULTATET

Tek ky kapitull, të dhënat e dalura nga hulumtimi janë paraqitur përmes tabelave. Konkretisht përmes analizës së korrelacionit janë gjetur lidhshmëritë mes variablave të hulumtimit, rezultate të cilat kanë dalë të jenë joshignifikante për studimin në fjalë. Po ashtu, për analizimin e të dhënave me karakter kualitativ është përdorur analiza tematike, ku nga përgjigjet e pjesëmarrësve janë definuar kodet e pastaj kategoritë/temat të cilat janë zbërthyer tek pjesa e rezultateve. Tema e parë madhore janë burimet e ndryshme të trajtimit, duke përfshirë qendrat e ofrimit të ndërhyrjes profesionale. Roli i ndërhyrjes profesionale është studiuar gjerësisht në literaturë dhe hulumtimi aktual tregoi se ndërhyrjet mund të jenë mënyra të mira për të reduktuar stresin prindëror. Tema e dytë që u zbulua ishte mbështetja familjare. Prindërit treguan se mbështetja e familjes e rriti aftësinë e tyre për të përballuar situatat e vështira dhe përmendën efektin pozitiv që kishin këto burime të mbështetjes në mirëqenien e tyre emocionale.

## KAPITULLI V: DISKUTIMI

Në këtë kapitull rezultatet e dalura nga ky hulumtim janë krahasuar me rezultatet e hulumtimeve të bëra jashtë vendit dhe nga kjo përmbledhje e rezultateteve kemi arritur të japim rekomandimet lidhur me ndikimin e strategjive të përballimit dhe reziliencës në prindërimin e fëmijëve me autizëm.

Pas rekomandimeve janë bashkangjitur referencat e hulumtimit, të gjeturat e të cilave janë pjesë e shqyrtimit të literaturës dhe në fund si shtojcë janë bashkangjitur pyetësorët që janë përdorur për të matur dhe vlerësuar variablat studiuuese dhe intervistat e realizuara me respondentët e studimit.